



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

K.DH.SH.II.nr. 697/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L....sh.p.k, me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson pronari G.V.nga Peja rr....., Qendra Tregtare S....., kundër të paditurës Komuna e Pejës– Drejtoria e Inspektionit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit D.S.G. nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.434/17 i datës 11.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 13.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e paditëses L....sh.p.k., me seli në Pejë, ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm– Divizioni Civil, C.nr.434/17 i datës 11.02.2021, dhe Lënda i kthehet Departamentit për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.434/17 i datës 11.02.2021 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses L....sh.p.k. me seli në Pejë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Pejës–Drejtoria e Inspektionit, që t’ia shpërblej dëmin material në lartësi prej 21,331.79€ dhe atë për dëmin material të rrënimit të objektit (pompës së derivateve) shumë prej 11,200.00€, për fitimin e humbur nga data 31.03.2017 deri me 23.07.2019 shumë prej 6,447.50€ dhe shumë prej 3,684.29€ për 16 muajt pasues , të gjitha këto me kamatë vjetore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënimin të përmbarrimit si të pabazuar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësja L....sh.p.k., me seli në Pejë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozimin që të anulohet aktgjykimi C.nr.434/17 i datës 11.02.2021 i Gjykatës Themelore në Pejë si i pabazuar, dhe çështja i kthehet për rishqyrtim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja L....sh.p.k., me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson pronari G.V. nga Peja rr., Qendra Tregtare “S.... nr....”, me datën 04.05.2017 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Pejës – Drejtoria e Inspeksionit, për shkak të dëmtimit të pronës dhe humbjes së fitimit, me të cilën ka kërkuar që ti shpërblehet dëmi i shkaktuar me veprimet e kundërligjshme të të paditurës Drejtoria së Inspeksionit, Sektori i ndërtimitarisë KK Pejë, të cilën me datën 31.08.2017 kishin marr vendim për rrënimin e objektit biznesor (pompës së benzinës e cila gjendet e ndërtuar në rrugën “....” në Pejë). Këto veprime e paditura i ka ndërmarr pa udhëhequr një procedure ligjore dhe në kundërshtim me vendimet gjyqësore pasi që paditësja ishte e pajisur me leje të punës, licence për operim me derivate. Ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesën padinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.434/17, i datës 11.02.2021 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Pejës –Drejtoria e Inspeksionit, që t’ia shpërblej dëmin material në lartësi prej 21,331.79€ dhe atë për dëmin material të rrënimin të objektit (pompës së derivateve) shumë prej 11,200.00€, për fitimin e humbur nga data 31.03.2017 deri me 23.07.2019 shumë prej 6,447.50€ dhe shumë prej 3,684.29€ për 16 muajt pasues.

Në arsyetim të Aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se pala paditëse me asnjë provë nuk e ka argumentuar bazën e kërkesëpadisë, se e paditura me veprimet e kundërligjshme ka shkaktuar dëm tek paditësja, po ashtu këto pretendimet nuk janë argumentuar nga paditësja me vendimin përfundimtarë qoftë të Organit Administrativ të shkallës së dytë apo nga organet gjyqësore mbi vlerësimin e ligjshmërisë se veprimeve të organeve administrative . Prandaj, mbi këtë bazë, gjykata duke u bazuar ne nenin 332.1 dhe 2, 7.2, 3.3 dhe 463 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1, pika (f) e LPK-së që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktgjykimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare dhe duke i’u referuar nenit 19 të LPK-së gjeti se secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore, ndërsa në rastin konkret gjeti se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 17.1 të LPK-së ku thuhet se “ Gjykata sipas detyrës

zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur” dhe nenit 29 të LPK-së ku thuhet se “në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj”.

Madje edhe duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054, *ka rezultuar* se paditësja nuk ka mundur të jetë palë në procedurë për këtë rast në këtë Departament të kësaj Gjykate, sepse paditësja e ka statusin shpk e shoqërisë tregtare.

Me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas kërkesëpadisë së paditëses duke mos pasur kompetencë lëndore për zgjedhjen e kësaj çështje juridike dhe në këtë rast ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1 pika (f) e LPK-së, që parasheh se shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston “në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër”. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, si fakt vendimtar në vendosjen e kësaj çështje juridike si në dispozitiv të aktgjykimit, ka marrë për bazë ndryshimet ligjore që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e shpallur ne gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës datë 10 shkurt 2022, i cili Ligj në dispozitën e nenit 13 paragrafi 2, ka përcaktuar qështjet që trajtohen në kompetenc të Departamentit për qështje ekonomike. Andaj duke marrë parasysh edhe objektin e kontestit në këtë çështje juridike, Kolegji erdhi në përfundim se Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetent të trajtoj këtë çështje juridike kontestimore.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se pala paditëse ka statusin SHPK, dhe me padi pretendon se me palën e paditur janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës se nenit 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.697/22 data 13.10.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Krenar Berisha